



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 165, datë 18.3.2022

P Ë R

NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.26, DATË 20.1.2021, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, "PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT,
PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT/RIKONSTRUKSIONIT
TË OBJEKTEVE ARSIMORE NË BASHKITË KAMZË DHE KAVAJË
DHE CAKTIMIN E TYRE SI NJËSI ZBATUESE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarjet "i" e "iii", 16 dhe 36, të aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr.97/2019, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr.115/2021, "Për buxhetin e vitit 2022", me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në vendimin nr.26, datë 20.1.2021, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, pas pikës 2 shtohet pika 2/1, me këtë përmbajtje:

"2/1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, për vitin 2022, për financimin e rindërtimit/rikonstruksionit të objekteve arsimore, në Bashkinë Kamzë, në masën 93 387 241 (nëntëdhjetë e tre milionë e treqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e dyqind e dyzet e një) lekë pa TVSH, i cili përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2022, i cili i transferohet Bashkisë Kamzë, në formën e transfertës së pakushtëzuar dhe detajohet, si më poshtë vijon:

- a) Rikonstruksionin e shkollës 9-vjeçare “Ahmet Zogu”, në masën 55 548 600 (pesëdhjetë e pesë milionë e pesëqind e dyzet e tetë mijë e gjashtëqind) lekë;
- b) Rikonstruksionin e shkollës 9-vjeçare “Kamza e re”, në masën 8 303 236 (tetë milionë e treqind e tre mijë e dyqind e tridhjetë e gjashtë) lekë;
- c) Rikonstruksionin e kopshtit “Kamza e re”, në masën 3 953 757 (tre milionë e nëntëqind e pesëdhjetë e tre mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e shtatë) lekë;
- ç) Rikonstruksionin e kopshtit “Ahmet Zogu”, në masën 15 581 648 (pesëmbëdhjetë milionë e pesëqind e tetëdhjetë e një mijë e gjashtëqind e dyzet e tetë) lekë;
- d) Rindërtimin e çerdhes Kamzë, në masën 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë”.

2. Ngarkohen Zëvendëskryeministri dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Kamzë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në “Fletoren zyrtare”.

KRYEMINISTRI

EDIRAMA

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI
DHE MINISTËR I SHTETIT PËR RINDËRTIMIN
DHE PROGRAMIN E REFORMAVE**

ARBEN AHMETAJ

NR.PROT. 1548/I
DATE 18.3. 2022

ZËVENDËSKRYEMINISTRIT DHE MINISTËR I
SHTETIT PËR RINDËRTIMIN DHE PROGRAMIN E
REFORMAVE
MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË
BASHKISË KAMZË
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjëll AGAÇI

